Isolor Roof

Izolues çatie elastik akrilik

Rendimenti i mbulimit: 1 - 3 m²/lt

Koha e tharjes: 2 - 3 orë

Hollimi: 5 - 10% për vëllim të holluar me ujë.

Mundësia për shtresë të dytë: 12 - 14 orë

Paketimi: 3 lt, 9 lt

Aplikimi: Me furçë, rul, spatul, furçë e trashë

KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Material izolues elastomerik akrilik me veti të shkëlqyera izoluese. Ndjek tkurrjet-zgjerimet e sipërfaqes pa u çarë dhe rrjepur, ndërsa në të njëjtën kohë izolon dhe mbron nga lagështia, shiu dhe dielli. Mbron përforcimin e betonit nga erozioni, duke parandaluar depërtimin e dioksidit të karbonit atmosferik në sipërfaqe. Izoluesi i çatisë mund të zvogëlojë temperaturën në ambiente të brendshme deri në 5 ºC në muajt e verës. Është zgjidhje e besueshme dhe me kosto efektive për rezistencë ndaj ujit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Graviteti specifik	1,32 - 1,36 kg/lt.
Rendimenti i mbulimit	1 - 3 m²/lt në varësi të aftësisë përthithëse të sipërfaqes.
Hollimi	5 - 10% për vëllim të holluar me ujë për shtresën e parë. Për shtresën e dytë nuk hollohet.
Koha e tharjes	E thatë për tu prekur në 2 - 3 orë, në varësi të kushteve të motit.
Mundësia për shtresë të dytë	Të paktën pas 12 - 14 orësh. Këto afate kohore janë më të gjata në kushte të ftohta moti dhe me lagështirë.
Kategoria e POA	"Bojëra për mure të jashtme me substrate mineralesh". Lloji Y. Vlera e pragut të POA = 40 g/lt. Përmbajtja maksimale e POA për produktet e gatshme = 15 gr/lt. POA: përbërësit organik të avullueshëm me pikën e zierjes < 250 ºC.
Rezistenca ndaj ujit & alkalineve	Rezistenca ndaj ujit dhe alkalineve.
Elasticiteti	Produkti shfaq veti elastike deri në 400 % në një trashësi shtrese të thatë prej 500 μm dhe në një temperaturë prej 20 ºC. Elasticiteti i tij ruhet në një masë shumë të madhe në intervalin e temperaturave -10 ºC deri në 60 ºC.
Ngjyra	E bardhë.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Për të siguruar që boja të ngjitet siç duhet, sipërfaqja që do të lyhet duhet të pastrohet nga pluhuri, yndyrat, vaji, të kruhet boja e vjetër, copëzat e lira, mbetjet e mykut, etj. Katrani dhe poliuretanet e zgjeruara duhet të lyhen duke përdorur astar SMALTOX hydro ose astar SMALTOX mono. Çimentot, suvatë, tjegullat e çatisë fillimisht duhet të lyhen duke përdorur astarin SMALTODUR të holluar në 20 % - 40 % me White Spirit ose Smaltoplast Universal Primer të holluar deri në 50 % me ujë.

APLIKIMI

Përzieni mirë përpara përdorimit. Shpërndajeni bojën në mënyrë të njëtrajtshme në sipërfaqe. Aplikoni 2 shtresa Isolor Roof në mënyrë të njëtrajtshme. Nyjat e zgjerimit dhe çarjet e mëdha mund të bashkohen duke përdorur fibra qelqi ose pëlhurë poliestër të ngopur me Isolor Roof të patretshëm. Çarjet dhe nyjat më të vogla mbushen para se të lyhet me Stuko Elastike Smaltofill.

PASTRIMI I MJETEVE

Gjatë punës, mbajini mjetet "të njoma" në enë ose në tabakanë me bojë. Kullojeni bojën mirë nga mjetet kur ta hidhni përsëri në kuti dhe pastrojini ato me ujë të ngrohtë me sapun. Nëse boja thahet, ajo mund të hiqet vetëm me detergjente të fortë. Mos i zbrazni ujërat që keni larë mjetet në ujërat nëntokësorë.

KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura 8 - 30 ºC dhe niveli relativ i lagështisë më i ulët se 80 %. Kushtet e këqija gjatë aplikimit mund të ndryshojnë vetitë e produktit në fund.

RUAJTJA

Ruajini në një vend të freskët, mbroni materialet nga ngrirja dhe ekspozimi në diell. Mbylleni fort enën pas aplikimit. Rimerreni bojën që ka tepruar për ta përdorur përsëri. Ripërdorimi i ngjyrave mund të minimizojë ndjeshëm efektet në mjedis të ciklit të jetës së produkteve.

SHËNIME

Produkti VINYL ROOF nuk kërkon ndonjë etiketë rreziku në përputhje me Legjislacionin Kombëtar dhe Evropian në fuqi.

UDHËZIME PËR PËRDORIM TË SIGURT

Lexoni etiketën përpara përdorimit. Mbajeni larg fëmijëve

Të dhënat dhe udhëzimet teknike në këtë broshurë teknike bazohen në testet laboratorike dhe janë rezultat i njohurive dhe përvojës së stafit shkencor të shoqërisë. Cilësia e produktit garantohet nga shoqëria, i cili është në përputhje me kërkesat e ISO 9001,14001 dhe me rregulloren e EMAS. Si prodhues, ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi për asnjë dëm apo dëme të shkaktuara nëse produkti nuk është aplikuar për përdorimin e duhur dhe në përputhje me udhëzimet për përdorimin.